



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
INSTITUTI I SHËNDETTIT PUBLIK  
TIRANË


Rruga: “Aleksandër Moisiu”, Nr 80, Tiranë, Albania.  
Tel: +355 4374756, Fax 355 43 70058

Tiranë, 23/11/ 2009

BULETINI EPIDEMIOLOGJIK MBI QARKULLIMIN E GRIPIT TE RI  
PANDEMIK A(H1N1) NE SHQIPERI


Me poshte jepet nje pershkrim i gjendjes epidemiologjike dhe pasojave shendetesore lidhur me Gripin e ri pandemik A(H1N1) ne Shqiperi deri ne daten 23 Nentor 2009.

**Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 25 - 46 të vitit 2008 dhe të vitit 2009. Numri i rasteve. (përkatesisht deri me dt. 15. 11. 2009).**




- Kemi nje numer me te larte te infeksioneve respiratore krahasuar me nje vit me pare. Kete jave verejme nje trend ne rritje te numrit te infeksioneve respiratore krahasuar me javen paraardhese. Aktualisht jemi ne fazen e aktivitetit sezonal te pritshem.
- Numri me i madh i rasteve te infeksioneve respiratore akute verehet ne moshat feminare.

**Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000**




- Ka një rritje të qëndrueshme të infeksioneve respiratore akute të raportuara çdo javë. Nuk kemi shpërthim epidemik të infeksioneve të ngjashme me Gripin. Numri javor i rasteve është ende i ulët krahasuar me pragun epidemik
- Lidhur me gripin e ri A/H1N1, deri në datën 23 Nëntor 2009, janë marrë 1667 mostra nga Tirana dhe rrethet. Numri më i madh i mostrave është marrë në grupmoshën 25 - 44 vjeç ku dhe vihet re dhe numri më i madh i rasteve të konfirmuara.
- Numri i përgjithshëm i rasteve të konfirmuara me virusin A(H1N1) deri në datën 23 Nëntor 2009 është **169**. Moshë mesatare e rasteve të prekura në total është 21 vjeç ndërsa e rasteve të javës së fundit është 17.5 vjeç. Shumica dërrmuese e rasteve janë konfirmuar në Tiranë.
- Përveç virusit të Gripit të Ri Pandemik A/H1N1 çdo ditë konfirmohen raste me virusin e Gripit të Zakonshëm Stinor cka dëshmon qarkullimin e përbashkët të dy viruseve në popullatë. Rreth një e katërta e rasteve të konfirmuara laboratorikisht janë grip A stinor.
- Shenjat klinike të rasteve të konfirmuara gjatë dy javëve të fundit kanë qenë të lehta dhe mesatare. Është regjistruar një rast i rëndë (sindrom i rëndë respirator akut), i shtruar në spitalin pneumoftiziatrik dhe një rast tjetër i rëndë me gripin stinor i shtruar në Spitalin Infektiv, QSUT.
- Survejanca në të gjithë vendin është plotësuar me informacionin mbi shtrimet në të gjitha spitalet e vendit dhe është përforcuar survejanca për zbulimin dhe monitorimin e rasteve me sëmundje të rënda respiratore.


### Shperndarja e rasteve te konfirmuara sipas javes se raportimit



### Shperndarja e rasteve te konfirmuara sipas grupmoshes



## Shperndarja e rasteve te konfirmuara sipas rretheve



**Frekuenca e hasjes së Infeksioneve Respiratore (të Sipërme dhe të Poshtëme) sipas rretheve në javën e 45-të dhe javën e 46-të të vitit 2009. Incidenca (raste/10.000)**

